

RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

JANAR – QERSHOR 2022



**KOMUNA
RAHOVEC**

PËRMBAJTJA

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	1
--------------------------------------	---

KRYETARI I KOMUNËS

Fjala hyrëse

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2022, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmuor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – qershor 2022.

Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të Komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale. Raporti gjashtëmuor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar, në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2022, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitesh përgjatë kësaj periudhe raportuese. Në vazhdim DSHP ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë kryer disa punë të intervenimeve emergjente,
- Është përfunduar sipas ligjit të ri vlerësimi i punëtorëve gjatë kësaj periudhe, deri më 31 janar;
- Kanë vazhduar punën me 3 kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, edhe pse nuk ka pasur të reshura të borës, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e disa problemeve me ndriçim publik, në Sapniq, Drenoc, në Malësi të Vogël, të gjitha këto janë pjesë e garancionit të projektit të zgjerimit të ndriçimit publik;
- Janë dërguar ftesat zyrtare kompanive që kanë kontratë me komunën e Rahovecit, që të sjellin planet e fillimit të punimeve duke respektuar afatet ligjore.
- Kemi angazhuar stafin në detyrat dhe bashkërendimin me drejtoritë të tjera në detyrat që janë dhënë në lirin e hapësirave publike dhe inkasimin e mjeteve në shfrytëzimin e këtyre pronave;
- Është bërë ri-marrëveshja e re me KRU Gjakovën;
- Kemi pasur takim me donatorët për zgjerimin e kamerave që përfshin fazën e dytë rrugën tranzite dhe fshatin Hoçë e Madhe, takime me donatorë Italian për panela solare, takime me donatorin JICA për reformat në menaxhim të mbeturinave;
- Është bërë grupi punues lidhur me draft planin për rrezikshmëri;
- Është bërë lidhja e kontratave në 3 lote, për mirëmbajtjen e rrugëve lokale gjatë sezonës dimërore dhe verore.
- Kanë filluar punimet me ndërtimin e rrugëve LOT 1;
- Kanë filluar punimet në Drenoc, në ndërtimin e rrugëve lokale;
- Kemi filluar punimet në sanimin e një rruge në fshatin Xërxë;
- Ka vazhduar krasitja e drunjve dekorativ në qytet dhe në disa fshatra nga kompanitë e kontraktuara;
- Kanë përfunduar punimet në shtrirjen e rrjetit të ujerave të zeza në dy lagje të fshatit Zaqisht, me gjatësi 350 metra dhe 230 metra, vazhdojnë punimet në Rahovec në Lagjen e Epërme;
- Është duke u përgatit plani investiv dhe kërkesat e qytetareve për periudhën 2023-2028 nga ana e KEDS-itL
- Janë bërë disa intervenime emergjente në rregullimin e disa ujëmbledhësve, është bërë rregullimi i trotuareve në Malësi, në Çifllak, si dhe do të kujdesemi edhe në disa zona tjera për shkak të demolimit;

- Jemi kujdesur në mirëmbajtjen e hapësirave publike, në pastrim të rrugëve dhe hapësirave tjera rreth institucioneve, si parqe, oborre, lapidare;
- Ka përfunduar projekti për vendosjen e paneleve solare në palestrën sportive "Mizahir Isma", nga donatorët KFOR-i Italian;
- Është bërë shpërndarja e kontejnerëve 1300 janë shpërndarë nga KRM Ekoregjioni dhe 700 nga kompania Ekodrinia, është bërë shpërndarja sipas listës dhe kërkesës së Komunës së Rahovecit;
- Janë dërguar ftesat zyrtare kompanive që kanë kontratë me komunën e Rahovecit, që të sjellin planet e fillimit të punimeve duke respektuar afatet ligjore.

Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor 2022

- Kanë filluar punimet me ndërtimin e rrugëve lokale sipas kontratave të ndara në lote, punimet kanë përfunduar në njërin segment në Brestoc, po vazhdojnë punimet në Krushë te Madhe, janë rikthyer punimet në Xërxë nga kompania Gashi-ING si dhe janë rikthyer punimet në ndërtimin e rrugëve lokale në Dejnë nga kompania Seti Comerc;
- Kanë përfunduar punimet në shtrirjen e rrjetit të ujërave të zeza në fshatin Nagac, po ashtu kanë përfunduar punimet në lagjen Berisha në fshatin Drenoc;
- Gjatë kësaj periudhe jemi kujdesur në mirëmbajtjen e hapësirave publike, në pastrim të rrugëve dhe hapësirave tjera rreth institucioneve, si parqe, oborre, lapidare, si dhe ka filluar eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Ka filluar puna në draftin e ri të dokumentit për mobilitet;
- Janë mbajtur dy takime me grupin punues për reforma në menaxhim të mbeturinave me donatorët JICA;
- Jemi duke koordinuar me zyrtarët për mjedis në bashkëpunim me GIZ dhe partnerë të tjerë numrin e deponive ilegale, disa janë eliminuar disa po presim të eliminohen sipas mundësive në terren;
- Ka filluar mirëmbajtja e ndriçimit publik, po ashtu kanë rifilluar punimet në zgjerim të ndriçimit publik, në fshatrat Hoçë e Vogël dhe Brestoc.

Korrik 2022

Drejtorja e Sherbimeve Publike

